

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)


 - **Nga:** Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

 - **Datë:** 12 janar 2022
 - **Lënda:** RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 1 tetor – 31 dhjetor 2022
-

Gjykata Supreme e ka përmbyllur vitin 2022 me 1.634 lëndë të kryera, derisa janë trashëguar për vitin 2023 vetëm 201 sosh.

Sa i përket tremujorit të IV-të të vitit 2022, të kryera rezultojnë 523 lëndë, derisa të pranuarat gjatë kësaj periudhe, kanë qenë 353 lëndë.

1. E paraqitur ne grafikun, duket kwshtu:



Rrjedh se numrin më të madh të lëndëve të kryera gjatë kësaj periudhe raportuese e përbëjnë Revizionet (R) me 203 lëndë të kryera, duke u renditur pas tyre Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë (PML), me 159 lëndë të kryera dhe Kërkesat për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm Administrativ (ARJ) me 59 lëndë të kryera.

Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe, që përfshijnë:

159 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë,


203 Revizione,

32 Revizione ekonomike.

24 kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

59 kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm administrativ

23 ankesa administrative.



2.Lëndët e kryera, sipas kërkesave të pranuar

E kalkuluar në përqindje, shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve, del të jetë 150.70 pwr qind, duke llogaritur numrin e lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, gjatë periudhës raportuese.



Seancat e Përgjithshme të Gjykatës Supreme

Gjatë tremujorit të IV-të, është mbajtur një Seancë e Përgjithshme e Gjykatës Supreme, ku kanë marrë pjesë gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe ata të Dhomës së Posaçme të kësaj gjykate, dhe ku unanimisht, janë aprovuar;

- **Mendimi Juridik lidhur me shlyerjen grupore (shlyerjen në bllok) nga evidenca penale të të gjitha dënimeve që janë shqiptuar nga gjykatat në Kosovë që nga viti 1999 e tutje,**
- **Qëndrimi Parimor lidhur me kontestet e punës dhe**
- **Udhëzuesi lidhur me rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor¹.**

Caktimi i U.D. Kryetares së Gjykatës Supreme

Me datë 14 dhjetor 2022, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka caktuar gjyqtaren Mejreme Memaj ushtruese të detyrës së kryetares së Gjykatës Supreme. Ky caktim është bërë pas lirimimit nga detyra të kryetarit të deriatëhershëm, Enver Peci, i cili dha dorëheqje, pasi me datë 24 nëntor 2022, Kuvendi i Kosovës e propozoi për dekretim tek Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Gjyqtarja Memaj, nga data 14 dhjetor 2022 është U.D. kryetare, deri në zgjedhjen dhe emërimin e kryetarit/es së Gjykatës Supreme².

Takimi i parë i Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e dy Planeve Strategjike të KGjK-së

Gjatë muajit nëntor, është mbajtur takimi i parë i Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025, si dhe Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 – 2024.

¹ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/11/07/mbahet-seanca-e-pergjithshme-e-gjykates-supreme-miratohet-nje-mendim-juridik-nje-qendrim-parimor-dhe-nje-udhezues/>

² <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/12/14/keshilli-gjyqesor-i-kosoves-ka-caktuar-gjyqtaren-mejreme-memaj-ushtrues-te-detyres-se-kryetares-se-gjykates-supreme/>

Anëtarët e Komisionit kanë diskutuar për aspektet teknike se si do të monitorojnë planet në fjalë, duke theksuar nevojën e hartimit të planit të punës, por edhe të pajisjes me informacione nga gjykatat dhe KGJK, në mënyrë që të trajtohen me urgjencë disa pika të këtyre planeve, të cilat kërkojnë vlerësim dhe raportim, siç është trajtimi i lëndëve të korrupsionit³.

Publikimi i vendimeve

Gjatë tremujorit të IV-të, Gjykata Supreme ka vazhduar me publikimin e aktgjykimeve dhe aktvendimeve. Kështu, gjatë kësaj periudhe janë publikuar gjithsej 850 vendime, prej tyre 516 vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Gjatë muajit tetor 272 vendime, gjatë muajit nëntor janë publikuar 270 vendime, ndërsa gjatë muajit dhjetor janë publikuar 308 vendime⁴.



4. Gjatë tremujorit të IV-të, janë publikuar 850 vendime

³ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/11/17/mbahet-takimi-i-pare-i-komisionit-per-monitorimin-vleresimin-dhe-raportimin-e-dy-planeve-strategjike-te-kgjk-se/>

⁴ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

RAPORT PËR PUNËN NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS NË PRISHTINË					
PËR PERIUHDHËN 1.10.2022 DERI MË 31.12.2022					
	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "PA"	1	0	1	1	0
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	29	150	179	159	20
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	1	28	29	24	5
Revizion "Rev" "Rev II"	242	98	340	203	137
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	14	2	16	7	9
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	1	0	1	1	0
Civile të ndryshme "CN"	2	4	6	4	2
Revizione ekonomike "E.Rev"	40	6	46	32	14
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	0	0	0	0	0
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmerise administrative "AML"	0	0	0	0	0
A.Rev.	0	2	2	2	0
ARJ	34	35	69	59	10
Ankesa administrative "AA"	6	20	26	23	3
Mbrojtje e ligjshmerise kundervajtje "KML"	0	3	3	2	1
Ankesa per paraburgime "PN.II"	1	2	3	3	0
Penale Ndihme Juridike Nderkombetare "PNJD"	0	0	0	0	0
Administrative të ndryshme "AN"	0	3	3	3	0
Gjithsej	371	353	724	523	201